



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:233038

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06626140

**AC-I-23-0465**

**Në ankesën e:**

***Paditësi***

**H M** fshati T, Komuna e Ferizaj, i përfaqësuar nga D B avokat, Ferizaj.

**Kundër:**

***E paditura/ankuesja***

**N.SH "Eurometal"**, (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Asllan Krasniqi gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit Shkallës së parë të DHPGJS C-VI-14-6607, të datës 24 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 19 dhjetor 2024, lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJS, C-VI-14-6607, i datës 24 korrik 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 21 tetor 2014, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI057-0272 të datës 11 korrik 2013, me të cilën kërkesa e tij për pagesën e pagave për periudhën maj-tetor 1990 në shume prej 1,086.00 euro, është refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se edhe pas kërkesës për të ofruar dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës, paditësi nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara, andaj bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së është refuzuar kërkesa për paga. Në ankesë paditësi ka pohuar se ishte në marrëdhënie të përhershme pune në N.SH Fabrika e Këmbyesve të Nxehëtisë "Faknit" në Ferizaj, e cila para privatizimit është emërtuar N.SH "Eurometal" e që tani është në procedurë të likuidimit. Tutje paditësi pohon se ai ishte larguar nga puna në vitin 1990 me një vendim arbitrar e të kundërligjshëm dhe pastaj ka paraqitur një padi në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, me të cilin është kërkuar anulimi i vendimit për largim nga puna si dhe kompensimit i të ardhurave personale për periudhën maj - tetor 1990. Tutje ai pohon se kjo padi nuk është zgjidhur dhe lënda pastaj ka kaluar në Gjykatën Komunale në Ferizaj. Paditësi po ashtu pohon se Autoriteti i Likuidimit pa ndonjë bazë e ka refuzuar kërkesën meqë N.SH-ja është përgjegjëse për pagat e pa paguara për periudhën e cekur. Paditësi me ankesë ka bashkangjitur: Vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit, njoftimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt Ref.nr.Gj.A.nr.414/2019 të dt.10 maj 2013, një listë të paguarave dhe të papaguarve për punëtorët për vitin 1990, nr.114, propozimin drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar Prishtinë për pagimin e të ardhurave personale 04 shkurt 1991, Regjistri i punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pran N.SH Eurometal- Ferizaj, për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, të vitit 1990 nr.08 dt.27 mars 2006, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë A.nr.251/2006 i datës 21.01.2008 si dhe autorizimin për përfaqësim nga avokati. Ka kërkuar që ankesa e tij të aprovohet lidhur me shumën e kërkuar si dhe ka kërkuar kamatën dhe shpenzimet e procedurës.

Me 07 mars 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të sakte të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregoj se cili nen i Shtojcës së Ligjit të AKP-

së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP-ja pohon se vendimi i Autoritetit të Likuidimit nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozite ligjore sepse paditësi edhe pas kërkesës për të ofruar dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës, nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara, andaj bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së është refuzuar kërkesa për paga. Ai ka dështuar të sjell dëshmi në mbështetje të kërkesës. Andaj nga këto arsyeje me të drejtë është refuzuar kërkesa me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Bashkë me këtë parashtrësë AKP-ja ka dorëzuar vendimin e AL GJI057-0272.

Me 24 mars 2023, përfaqësuesi i paditësit ka dorëzuar përgjigje ndaj mbrojtje së të paditurës dhe ka bashkangjitur përsëri provat të cilat i kishte dorëzuar me ankesë.

Me 06 prill 2023, e padatuara ka paraqitur kundërpërgjigje, dhe i ka propozuar gjykatës që ankesën e paditësit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e AL.

Me 24 korrik 2023, Shkalla e parë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-6607 e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të pa bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit GJI057-0272, dhe e ka obliguar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën maj – tetor 1990, t'i paguaj shumën prej 1,086.00 € dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 108.60 €, sipas prioritetit të kërkesave në procedurë të likuidimit, ndërsa ka refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësit për kamatën vjetore prej muajit prill 2006 deri në pagesën definitive. Shkalla e parë ka arsyetuar se nuk është kontestuese fakti që paditësi ishte ishte një punëtor i N.SH "Eurometal" (ish – FAKNIT). Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune paditësi dhe a i ka mbetur borxh pagat N.SH për periudhën maj – tetor 1990 (6 paga). E paditura e kundërshton kërkesën e paditësit duke pretenduar se i njëjti nuk ka ofruar prova, pasi paditësi nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, ashtu që edhe pas kërkesës së AL dokumentacioni i padiankuesit mbetet jo i plotë. Tutje ka arsyetuar se paditësi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në provat e dorëzuara me ankesë. Nga propozimi për pagesën e të ardhurave personale drejtuar Gjykatës Themelore

të Punës së Bashkuar në Prishtinë, në mesin e propozuesve gjendet edhe emri i paditësit.

Nga, lista e pagave të papaguara të punëtorëve të N.SH-së për periudhën maj – dhjetor 1990, datë 07 maj 1991 dhe regjistri i punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur nga NSH gjatë vitit 1990, vërtetohet fakti se N.SH-ja i ka mbetur borxh paditësit shumë prej 1,086.00 €. Këto dëshmi gjykata i ka pranuar pasi të njëjtat janë të nënshkuara dhe vulosura nga personat përgjegjës të NSH-së.

E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listat e pagave të dorëzuara nga paditësi. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar, nuk është i saktë. Paditësi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve në AL me 27 mars 2008. Shkalla e parë po ashtu ka vlerësuar se, kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar pasi paditësi së bashku me ish-punëtorët e tjerë të NSH-së kanë parashtruar padi për kompensim të pagave të mbetura borxh në vitin 1992 në gjykatë dhe në vazhdimësi kanë kërkuar pagesën e të ardhurave personale për periudhën objekt kontesti, prandaj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Shkalla e parë e ka aprovuar edhe shumë në lartësi prej 108.60 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Me 10 gusht 2023, e paditura përmes postes parashtror një ankesë në DHPGJS kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6607 të datës 24 korrik 2023, për shkak të vërtetimit të gabuar të situatës faktike dhe vlerësimit të zbatimit të nenit 36.2.1 të shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI057-0272 i dt. 11 korrik 2013.

Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së parë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që

Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për paga është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga kur paditësi nuk ka përfituara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar.

Më 30 shtator 2024, ankesa e të paditurës i është dërguar përfaqësuesit të paditësit, por ai nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-VI-14-6607, i datës 24 korrik 2023, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 27 mars 2008 kishte parashtruar kërkesës për kompensimin e pagave për periudhën maj-tetor 1990 në shume prej 1,086.00 euro nga N.SH'' Eurometal'' Ferizaj, mirëpo Autoriteti i Likuidimit kërkesën e ka refuzuar si të pa vlefshme me arsyetimin se edhe pas kërkesës për të ofruar dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës, paditësi nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të AL, me Aktgjykimin C-IV-14-6607, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të pa bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit GJI057-0272, dhe e ka obliguar të paditurën që paditësit në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën maj – tetor 1990, t'i paguaj shumën prej 1,086.00 € dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 108.60 €, ndërsa ka refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësit për kamatën vjetore prej muajit prill 2006 deri në pagesën definitive.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së parë, nuk mund të pajtohet me konstatimin e gabuar të Autoritetit të Likuidimit se paditësi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme apo se kërkesa është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së parë të DHPGJS-së, ka sjellë si prova: Vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit, njoftimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt Ref.nr.Gj.A.nr.414/2019 të dt.10 maj 2013, një listë të paguarave dhe të papaguarve për punëtorët për vitin 1990, nr.114, propozimin drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar Prishtinë për pagimin e të ardhurave personale 04 shkurt 1991, Regjistri i punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pran N.SH Eurometal- Ferizaj, për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, të vitit 1990 nr.08 dt.27 mars 2006, dhe Aktvendimin e Gjykatës se Qarkut në Prishtinë A.nr.251/2006 i datës 21.01.2008.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ka kërkuar pagat e pa paguara për periudhën maj-tetor 1990, duke pohuar se ai ishte larguar nga puna me një vendim arbitrar dhe të kundërligjshëm dhe se ai kishte udhëhequr procedurë gjyqësor që nga koha e largimit nga puna, mirëpo nuk kishte marr asnjëherë vendim gjyqësor, prandaj kishte paraqitur kërkesë me kohë te Autoriteti i likuidimit.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi ka pohuar se lidhur me Propozimin ka filluar procedura në Gjykatën Themelore në Prishtinë, por procedura nuk ka përfunduar dhe nuk i është dhënë kurrfarë njoftimi lidhur me fatin e kësaj lënde, andaj aktgjykimi i shkallës së parë është saktë. Kolegji i Apelit po ashtu vëren se paditësi

si kreditor iu ka përmbajtur dhe ka ndjekur procedurat ligjore dhe ka paraqitur me kohë kërkesë për paga tek AL.

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-034 Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht Neni 10 para 1, fletë për Pezullimin e Veprime në rastet që *“Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit”*. Pra sipas kësaj dispozite edhe në situatën e paditësit që ishte duke ndjekur çështje juridike para një Gjykate, me hyrjen e NSH-së në likuidim procedura para gjykatës është dashur të pezullohej. Prandaj nuk është e rëndësishme përgjigja se a ishte i interesuar paditësi ta përfundoj çështjen e tij në gjykatë siç kishte kërkuar AL, pasi që procedura në gjykatë edhe ashtu është dashur të pezullohet, prandaj çështja e ngritur nga AL se paditësi a ka kërkuar vazhdimin e procedurës ka qen jo relevante.

Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi në ankesën e tij në Shkallen e parë por edhe me parashtresën e dorëzuar, si përgjigje ndaj urdhrit në shkallën e parë ka dorëzuar prova të mjaftueshme për ta provuar të drejtën e tij për paga të papaguara. Pra paditësi në fakt ashtu siç parasheh neni 42 par. 2 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme, ka dëshmuar mjaftueshëm vërtetësinë e pretendimit të tij duke paraqitur prova dhe dëshmi materiale.

Kolegji i Apelit vlerëson se me të drejtë shkalla e parë ka konstatuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se paditësi ishte një punëtor i N.SH “Faknit” tani “Eurometal” në Ferizaj. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve ishte çështja e të provuarit se a i ka mbetur N.SH borxh paga të pa paguara paditësit e të cilën shihet se paditësi e ka dëshmuara me prova të mjaftuara.

Me kopjen e propozimit për pagimin e të ardhurave personale drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar vërtetohet se në mesin e propozuesve gjendet edhe emri i paditësit. Me regjistrin e punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pranë N.SH “Faknit” për muajt maj – tetor 1990, e cila përmban vulën e N.SH “Eurometal” me nr.08 dhe dt.27.03.2006 shihet se se në mesin e punëtorëve

gjendet emri i paditësit H M. Ky regjistër është i nënshkruar nga Kryetari i punëtorëve - S.V, Drejtori K - Q.Q dhe Financat - H.A dhe se i njëjti është i vulosur me vulën e N.Sh-së. Andaj edhe Kolegji i Apelit i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat të cilat i ka sjell paditësi në Shkallë e parë dhe ka ardhur në përfundim se paditësi ka ofruar shërbime punë për N.SH për periudhën maj – tetor 1990 dhe se për këtë periudhë i takon kompensimi për paga të papaguara në shumë prej 1,086.00 euro.

E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.SH-në në periudhën e lartcekur, apo se nuk i takon kompensimi për paga.

Kolegji i Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje .

Prandaj duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se Shkalla e parë e DHPGJS ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur kompensimin për paga në shumën e lartcekur si dhe interesin ligjor prej 10% të shumës themelore.

Andaj nga se u tha më lartë, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar, nuk ka mundësi të ndryshohet, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat Gjyqësore**

Ankuesja-AKP, e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me dt.17 gusht 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 19 dhjetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_